

VENDIM
Nr. 71, datë 10.5.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “POWER AND GAS OPERATIONS” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Power and Gas Operations” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Power and Gas Operations” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 308 prot., datë 23.4.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Power and Gas Operations” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “a” (akti i themelimit), germa “e” (Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit (në përputhje me veprimtarinë për të cilën kërkohet licenca)).

Do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Power and Gas Operations” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti